

VENDIMËSHTË I PLOTFUQISHËM
 QILKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC **NË EMËR TË POPULLIT**

Më
 Datë

25-09-2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM -

DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues, Adem Shabani, me procesmbajtësen Marigona Shaqiri, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.696-4/05 të datës 01.02.2007, pas përfundimit të shqyrtimeve gjyqësore publike me datën 19.06.2018 në praninë e prokurores së shtetit Mimoza Syla, të pandehurit [REDAKTUAR] dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit avokatit [REDAKTUAR] nga Ferizaj dhe me datën 22.06.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, i lindur me dt. [REDAKTUAR] nga babai [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e vajzërisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punë, i pa gjykuar më parë, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, me numër personal [REDAKTUAR] mbrohet ne liri,-

ËSHTË FAJTORE

Sepse:

Me datë 20.09.2005, rreth orës 19:40 minuta, në rrugën magjistrale Prishtinë-Kaçanik, përballë depos " Qorri Comerc ", në Ferizaj, ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre, me ç 'rast ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore neni 42.2 të LSKRR-së duke menduar me mendjelehtësi se nuk do te shkaktohet pasoja e ndaluar, ne atë mënyrë qe duke e vozitur veturën e tipit " Ford Eskort " me targa [REDAKTUAR] ne shpejtësi prej 50-60 km / h, pa vëmendje të përqendruar përpara duke mos e vërejtur këmbësorin kur ka kaluar nga bankina ne rrugën automobilistike, dhe me pjesën e përparme të

djathhtë të veturës e ka goditur dhe hedhur në trotuar këmbësorin- [REDAKTUAR], i cili në mënyrë të befasishme dhe të pakujdesshme kishte dalë në rrugën automobilistike duke i ikur gropës me ujë, dhe si pasojë e kësaj goditje këmbësori ka marrë lëndime të rënda trupore, nga te cilat pas 5 ditëve ndërron jetë në spital,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Gjykata duke u bazuar në nenet 3, 6, 11, 34, 41, 42, 43, 44, 64, 66, 67, të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe 450 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të pandehurit [REDAKTUAR], i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër të re penale.

II. Përfaqësuesi ligjor i tani të ndjerit [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe në emër të shpenzimeve paushallë aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate të paguajë shumën prej 564,34 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër e tridhjetë e katër cent) Euro, dhe taksën për viktimat e krimit në shumën prej 30 Euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka ngrit aktakuzë PP.nr.696-4/05 të datës 01.02.2007, kundër të pandehurit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 1 të KPPK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore me datat 24.03.2014, 25.05.2017, 04.07.2017, 20.04.2018, 25.04.2018, dhe vazhduar me 19.06.2018 kurse shpalljen e aktgjykimit e ka bërë me datën 22.06.2018.

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka paraqitur se pas përfundimit të procedurës hetimore dhe pas seancave kryesore në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] i cili është akuzuar për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me pas.1 të KPK-se, dhe nga provat e administruara janë argumentuar të gjitha faktet me të cilat pa mëdyshje vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Është vërtetuar se ditën kritike me dt.20.09.2005 rreth orës 19:40 në rrugën magjistrale Prishtine-Kaçanik përkatësisht përballë depos " Qorri Comerc ", i pandehuri me pjesën e përparme ballore të djathtë të automjetit ka goditur këmbësorin [REDAKTUAR], i cili në ato momente ka qene duke lëvizur përgjatë bankinës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes së automjetit ku në çastin kritik kishte ndërmarrë veprimin e anashkalimit të një pusetë të ujit dhe nga kjo goditje pas plagëve të marra ka ndërruar jete pas 5 dite në spital.

Nga ekspertiza e përpiluar nga ekspertit i komunikacionit [REDAKTUAR] si dhe dëshmia e tij dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.07.2017, ku ka theksuar se nga analiza detale e dokumentacionit që iu është ofruar nga gjykata ka ardhur në përfundim se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e goditjes së këmbësorit nga ana e veturës " Ford Escord ", vetura ka lëvizur me shpejtësi 50-60 km/h, këmbësori-viktima ka lëvizur së bashku me një këmbësor tjetër për skaj rrugës në anën e djathtë në bankinë, vozitësi i veturës nuk i vëren fare këmbësorët dhe ndalet vetëm pasi e godet viktimën duke mos e ditur se çka ka goditur.

Eksperti në ekspertizë e komunikacionit ka konstatuar se kujdesi i vozitësit është dashtë të jete më i shtuar që të vërej këmbësorët që lëvizin përskaaj rrugës dhe të vërente momentin kur këmbësori ka kaluar në rrugën automobilistike përpara tij. Nëse në momentin e rrezikut nuk do të kishte mjete nga ana e kundërt manovrimi i mjetit në të majtë do të ishte një opsion për ikjen e goditjes së këmbësorit-viktimës, mirëpo duke mos i vërejtur këmbësorët i pandehuri e ka humbur mundësinë e orvatjes për evitimin e këtij aksidenti.

Në mendimin e tij eksperti i komunikacionit ka konstatuar se përpos daljes së pakujdesshme të këmbësorit nga bankina në rrugën automobilistike këtij aksidenti i ka

kontribuar ngasësi i veturës “ Ford Eskort ”, nga ana e vozitësit pa vëmendje të përqendruar përpara duke mos vërejtur këmbësorët përkaj rrugës në anën e djathtë dhe nga pakujdesia dhe mos përqendrimi i duhur nuk e ka vërejtur këmbësorin-viktimën.

Edhe ne seancën gjyqësore të dt.04.07.2017, eksperti i komunikacionit [REDAKTUAR] ka mbetur pranë mendimit të dhënë në ekspertizën me shkrim të dt.22.01.2007 duke theksuar se vozitësi është dashur të ketë vëmendjen më të përqendruar në kushtet e papërshtatshme të zhvillimit të komunikacionit, pasi në kohën kur ka ndodhur aksidenti ishte natë, errësirë dukshmëria e zvogëluar, moti me rriga shiu dhe shtresa e rrugës e lagur.

Se i pandehuri është përgjegjës për kryerjen e kësaj veprë penale vërtetohet edhe nga Super ekspertiza e grupit të eksperteve të dt.22.09.2017, ku konstatohet se sikur i pandehuri të kishte rritur kujdesin gjatë lëvizjes në kushtet e dukshmërisë së kufizuar dhe të vërente me kohe lëvizjen e këmbësorit ka pasur mundësi të ndërmarrë veprimin e devijimit të trajektorës së lëvizjes majtas dhe ka pasur mundësi të shmangë goditjen e këmbësorit pa kaluar në shiritin e dedikuar për lëvizjen e automjeteve nga kahja e kundërt ku edhe lëshimet e ngasësit të automjetit “ Ford Eskort ” kanë qenë “ shume të vogla ”, duke mos treguar kujdesin e duhur gjatë lëvizjes në kushtet e dukshmërisë së kufizuar ku ka pasur mundësi teknike të ndërmarrë veprimin e devijimit të trajektorës së lëvizjes majtas.

I pandehuri [REDAKTUAR] në mbrojtjen e tij të dhënë e mohon kryerjen e kësaj veprë penale edhe pse nuk e mohon faktin se ditën kritike ka lëvizur automjetin “ Ford Eskort ” ku kishte ardhur deri te aksidenti dhe se është munduar ti ikë këtij aksidenti por se ky aksident kishte qenë i pashmangshëm e po ashtu pranon se ka goditur këmbësorin tani të ndjerin e i cili deklarim ka për qëllim ikjen nga përgjegjësia penale për veprën e kryer andaj gjykata këtij deklarimi nuk duhet ti falë besimin.

Gjendja faktike reale e kësaj çështje penale bindshëm është vërtetuar përmes provave tjera që i kemi dëgjuar gjatë seancave gjyqësore ku nga dëshmia e ekspertit prof. Dr. [REDAKTUAR] dhënë në seancën gjyqësore është vërtetuar se nga shkresat e kësaj lënde penale që i ka ofruar gjykata kishte qenë i mjaftueshëm për të dhënë e një mendim përfundimtar ashtu siç është dhënë në super ekspertizë i cili dokumentacion ka sqaruar aspektin teknik të aksidentit, duke vazhduar në deklarin se në super ekspertizë janë cekur lëshime e të pandehurit “ shume të vogla ” dhe për të sqaruar lëshimin konkret në këtë rast drejtuesi i automjetit “ Ford Eskort ”, është dashur të përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës dhe ka pasur

mundësinë që pa kaluar në shiritin e kundërt të evitohet aksidenti me një kujdes më të shtuar me një shpejtësi më të vogël se ajo që është lejuar. Më tutje eksperti deklaroi se të rastit konkret në faqen 11 të super ekspertizës është treguar hapësira në dispozicion që ka pasur ngasësi i automjetit dhe atë 2.75m, pra duke ia hequr 1m, të cilën e ka zënë këmbësori automjeti "Ford Eskort" është i gjerë 1749 mm që d.m.th. ka pasur hapësirë teknikisht të mjaftueshme që të anashkalojë këmbësorin, të gjitha këto konstatime nga ana e ekspertit vërtetohen qartë kryerjen e veprës penale nga i pandehuri, nga dëshmia e dëshmitarit [REDACTED] [REDACTED] dhënë në procedurën hetimore por edhe në shqyrtimin gjyqësor vërtetohet fakti se ditën kritike deri sa ka qene se bashku me viktimën tani të ndjerin [REDACTED] duke ecur rreth rrugës i njëjti ishte goditur nga një automjet. Po ashtu dëshmitari ka deklaruar se uniformën që e kishte pasur i ndjeri edhe sot e asaj dite firma Hib-Petrol e ka të njëjtën uniforme ku veshja e tij ka qene e gjelbër por ngjyra dalluese ka qene ngjyre e verdhe dhe se ka pasur të veshur jelekun e punës të shkruar Hib-Petrol. Mbrojtja e të pandehurit nuk mund të justifikohet bazuar në provat tjera sidomos nga deklarata e dëshmitarit, nga konstatimi i ekspertit dhe nga mendimi i ekspertëve në super ekspertizë dhe raporti i obduksionit dhe se të njëjtat janë dëshmi të pakontestueshme në argumentimin e kryerjes së veprës penale nga i pandehuri, i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj sanksionin e parapare me ligj.

Përfaqësuesi ligjor i të ndjerit - prindi [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.07.2017, ka deklaruar se në këtë aksident të komunikacionit ka humbur djalin tani të ndjerin [REDACTED], por me familjen e të pandehurit janë pajtuar sipas traditave familjare nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale kurse dëmshpërblimin e kërkon nga kompania e sigurimit ku i pandehuri ka pasur të siguruar veturën me të cilën e ka shkaktuar aksidentin dhe ka kërkuar nga gjykata që për shqyrtimet tjera gjyqësore mos ta fton pasi nuk është në gjendje që ti përballon situatës pasi të ndjerin e kishte djalë, e gjykata për realizimin e kërkesës pasur-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit me autorizim av. [REDACTED] fjalën përfundimtare e ka deponuar me shkrim por atë edhe e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor dhe ka deklaruar se bazuar nga deklarata e të pandehurit [REDACTED] ekspertiza e ekspertit të komunikacionit [REDACTED] dhe Super ekspertiza e grupit të ekspertëve nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë –

Departamenti i Komunikacionit në përbërje nga Prof.Dr. [REDAKTUAR] Msc. [REDAKTUAR] dhe Msc. [REDAKTUAR], dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe provave të tjera janë vërtetuar këto fakte vendimtare.

Se me datën 20.09.2005 rreth orës 19:40, pra kur ka qenë natë dhe me reshje shiu, terr i shtuar në krahasim me ditët tjera, duke vozitur automobilin pas një automjeti tjetër që lëvizte në të njëjtin drejtim, me koncentrim në pajtim me kushtet e dhëna në komunikacion, ka ardhur deri te fatkeqësia në komunikacion në rrugën Prishtinë-Kaçanik me ç'rast me pjesën e përparme të djathtë të veturës, i mbrojturi im e godet tani të ndjerin [REDAKTUAR], i cili pëson lëndime të rënda nga të cilat vdes pas 5 ditësh në spital.

Po ashtu, me këto prova është vërtetuar se në anën e djathtë të rrugës nëpër bankine kanë qenë duke udhëtuar dëshmitari [REDAKTUAR] me të ndjerin dhe kur kanë arritur te pjesa e bankinës e cila ka qenë e mbuluar me ujë dhe balte, duke formuar një pusët, [REDAKTUAR] këtë pusët e ka anashkaluar nga ana e djathtë, ndërsa i ndjeri [REDAKTUAR] këtë pusët me ujë dhe baltë e anashkalon nga ana e majtë, duke kaluar papritmas, befas në rrugën magjistrale, kur vetura me pjesën e farit dhe të shtyllës së anës së djathtë të përparme e godet të ndjerin.

Sipas ekspertizës së ekspertit të komunikacionit [REDAKTUAR] shpejtësia e lëvizjes së veturës ka qenë 50-60 km/h, i ndjeri kishte kaluar nga bankina deri në pikën e goditjes 1,0 metër, të cilën pjesë të rrugës, me ecje normale, me shpejtësi prej 5km/h e ka kaluar për 0.72 pjesë të sekondës. Këmbësorët nuk kishin mjet reflektues apo mjet ndriçues, i ndjeri ka kaluar pa kujdes dhe befasisht në rrugën automobilistike.

Duke marrë parasysh se i ndjeri ka lëvizur me shpinë të kthyer të veturës dhe për një kohë prej 0.72 pjesë të sekondës nga bankina në rrugë, duke marrë parasysh se koha e reagimit të vozitësit me frenim është 1.0 sekondë, atë se me rastin e veprimin të ndjerit nuk ka mundësi të evitimit të këtij aksidenti, pasi koha e paraqitjes së rrezikut është më e vogël se koha e reagimit të vozitësit.

Sikur këmbësorët të përdornin anën e majtë të rrugës, siç është paraparë edhe me rregullat e lëvizjes së këmbësorëve në rrugë, këmbësorët do të kishin mundësi ta evitonin aksidentin pasi që në kahen e lëvizjes do të përballë kalonin me automjetet dhe do të kishin mundësi më të mirë të perceptonin rrezikun.

Deri te aksidenti nuk do të vinte sikur viktimat ta anashkalonte pus-eten me ujë nga ana

e djathtë. Vozitësi i veturës nuk ka pasur mundësi të ikjes së aksidentit me frenim edhe sikur të kishte hetuar me parë këmbësorët në rrugë, sepse dalja e këmbësorit në rrugë ka qenë e papritur.

Eksperti i komunikacionit [REDAKTUAR] ka thënë se kujdesi i vozitësit është dashur të jetë më i shtuar ashtu që të vërejë këmbësorët që lëvizin përkajërës dhe të vërente momentin kur këmbësori ka kaluar rrugën automobilistike përpara tij. Nëse në momentin e rrezikut nuk të kishte mjete nga ana e kundërt, manovrimi i mjetit në të majtë do të ishte një opsion për ikjen e goditjes së këmbësorit, duke mos i vërejtur këmbësorët, vozitësi i veturës ka humbur mundësinë e orvatjes për evitim të këtij aksidenti. Ku sipas ekspertit ka dhënë mendimin se shkak i këtij aksidenti është dalja e pakujdesshme dhe e befasishme e këmbësorit nga bankina në rrugë automobilistike ku këtij aksidenti i ka kontribuar ngasja e veturës pa vëmendje të përqendruar përpara duke vërejtur këmbësorët për skaj rrugës dhe pa kujdesia e mos përqendrimi i duhur as nuk e ka vërejtur këmbësorin duke kaluar nga bankina në rrugë.

Sipas grupit të eksperteve të fakultetit që kanë përpiluar super ekspertizën lidhur me këtë rast shpejtësia e lëvizjes së automjetit ka qenë 54 km / h, për rastin e dukshmërisë së kufizuar "nate" grupi i eksperteve ka konstatuar se për shpejtësinë e lëvizjes prej 54km/h drejtuesi i automjetit nuk ka pasur mundësi teknike që me frenim të vullshëm ta evitonte goditjen e këmbësorit.

Në pjesën e rrugës në të cilën ka ndodhur aksidenti nuk ka pasur trotuar apo shteg të këmbësoreve, këmbësorët kanë pasur të drejtë të përdorin rrugën automobilistike për lëvizje me kusht që të lëvizin sa më afër skajit të rrugës dhe të lëshojnë rrugën mjeteve në kahjet e lëvizjes ku ekspertet nga fakulteti kanë dhënë mendimin se deri të aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve kryesore të këmbësorit, por në masë të vogël këtij aksidenti i ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit "Ford Eskort".

Grupi i ekspertëve kanë dhënë sqarime se lëshimet e këmbësorit kanë qenë se nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur lëvizjes së automjetit në rrugën automobilistike në mënyrë që të lëshojnë rrugën në rastin kur afrohen, kanë ndërmarrë veprimin e anashkalimit të pusëtës duke shfrytëzuar për lëvizje rrugën pa u siguruar paraprakisht se me këtë veprim do të rrezikoj vetën dhe pjesëmarrësit tjetër në komunikacion, pra lëshimet e ngasësit të automjetit "Ford Eskort", kanë qenë shumë të vogla dhe atë nuk ka treguar kujdesin e duhur gjatë lëvizjes në kushtet e dukshmërisë së kufizuar në mënyrë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për evitim të

aksidentit konkret ka pasur mundësi teknike të ndërmarrë veprimin e devijimit të trajektores së lëvizjes majtas.

Sipas mendimit të mbrojtësit të akuzuarit [REDAKTUAR] av. [REDAKTUAR] shkak i aksidentit të shkaktuar ka qenë lëvizja apo dalja në rrugë e pakujdesshme dhe e befasishme e këmbësorit, kur i akuzuari nuk ka vërejtur këmbësorin apo edhe po ta vërente duke marrë parasysh distancën nga skaji i rrugës deri te pika e kontaktit ishte vetëm një metër dhe shpejtësia 0.72 pjese të sekondës, lëvizja e pakujdesshme dhe drejtpërdrejtë e këmbësorit në rrugë me mos vërejtje të mundshme të lëvizjes së automjetit sipas vlerësimit tonë mendimi i ekspertëve se për kontributin e të mbrojturit se ka vozitur pa vëmendje të përqendruar apo kujdes të duhur duke mos vërejtur këmbësoret edhe me pakujdesi për shkak se nuk i ka vërejtur këmbësorin është në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike të lëndës, sepse përqendrimi i klientit tim ka qenë maksimal i përshtatur me kushtet e rënda të lëvizjes, në pajtim me parimin e besimit se të gjithë pjesëmarrësit e mundshëm në trafikun rrugor i përmbushin detyrimet ligjore pa shkelje të ligjit dhe për shkak të pamundësisë objektive që në situatën e rrezikshme të krijuar pa fajin e tij të ndërmerre ndonjë veprim që do të shpëtonte pasojën a ndaluar, respektivisht mosveprimi i tij që me ndonjë lëvizje përshpejtimin e fatkeqësisë objektivisht nuk mund të merret si shkak dhe pasoja e tij, përkatësisht sikurse është thënë në mendimin e ekspertit të komunikacionit [REDAKTUAR] se këtij aksidenti i ka kontribuar ngasja e veturës "Ford Eskort" nga ana e vozitësit të tij pa vëmendje të përqendruar përpara duke mos vërejtur këmbësoret për shkak të rrugës në anën e djathtë dhe nga pakujdesia dhe mos përqendrimi i duhur as nuk e ka vërejtur këmbësorin duke kaluar nga bankina në rrugën automobilistike. Mos vërejtja e këmbësoreve si fakt vendimtar nuk mund të objekti vizohet për të nxjerrë përfundimin për ekzistimin e shkakut në lëvizjen e të akuzuarit, kontributin e tij nga pakujdesia sikurse ka vepruar gabimisht eksperti sepse çështja e pamjes është çështje subjektive, si dhe pakujdesia të objekti vizohet duke mos vlerësuar lëshimet subjektive të këmbësorit pa sinjal drite, dalje në rrugë në mënyrë të befasishme dhe pa lëvizje pranë skajit të rrugës, e vetëm lëvizja pranë skajit të rrugës do të kishte qenë e mjaftueshme që të mos vinte deri te aksidenti, sikurse edhe ekzistimi i ndonjë ndriçimi.

Mendimi i ekspertit [REDAKTUAR] për kontributin e të mbrojturit tim është në kundërshtim diametral me fjalën kushtore të citur edhe më parë në të cilën është thënë " nëse në momentin rrezikut nuk do të kishte mjete nga ana e kundërt manovrimi i mjetit në të majte do të ishte një

opsion për ikje e goditjes së këmbësorit”, sipas mendimit të mbrojtjes nxirret konkluzioni se po të kishte mjete nga ana e kundërt nuk do të ekzistonte mundësia e manovrimit në të majtë dhe ikjes së goditjes direktet me mjete nga drejtimi i kundërt dhe mendimi i ekspertit është dhënë pa prova por nën supozimin se nuk kishte mjete nga drejtimi i kundërt.

Edhe mendimi i grupit të eksperteve për mundësinë e devijimit në të majtë ndonëse nuk thuhet por kuptohet se është dhënë nën supozimin se nuk do të kishte automjete nga drejtimi i kundërt përndryshe nuk mund të përjashtohet rreziku i përplasjes së drejtpërdrejtë të automjetit të të pandehurit me automjetet e mundshme nga drejtimi i kundërt meqë rast pasojat do të ishin më të rënda.

Aktgjykimi gjykues nuk mund të bazohet në supozime edhe mendimi i grupit të ekspertëve nuk përjashton me prova të sigurta mundësinë e përplasjes direkte të automjetit me devijimin në të majtë por shkak i fatkeqësisë ka qenë dalja e pakujdesshme dhe e befasishme e këmbësorit në rrugë ku sipas nenit 14 të KPK-së personi nuk është penalisht përgjegjës ku midis veprimit ose mos veprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore, ose kur nuk ka mundësi të shkaktohet pasoja kjo dispozite ligjore e përjashton edhe ekzistimin e pakujdesisë së pa evitueshme të mbrojturit tim sepse në kushtet ekzistuese të zhvillimit të komunikacionit objektivisht nuk ka mund të ndërmerret asnjë veprim me të cilën do të mund ta evitonte në tërësi ose të ndikonte që pasojat e fatkeqësisë të jenë më të vogla, kjo ngase nga përshkrimi i aktakuzës kuptohet pa mëdyshje se i mbrojturi im akuzohet për veprën penale të kryer nga pakujdesia e pa vetëdijshme sipas nenit 16 par.2 të KPK-se, “personi vepron me pakujdesi të pa vetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit sepse mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas viteve të tij personale ka mund të ishte apo duhet të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi. Lëvizja e të ndjerit ka qenë shkak i arritur më parë për shkak të vetëm në krahasim me mosndërmarrjen e devijimit të trajektores së lëvizjes në të majtë nga ana e të mbrojturit tim. Ku ekziston kauzaliteti i para ardhur apo kauzaliteti hipotetik, kauzaliteti i para ardhur e përjashton kauzalitetin e para ardhur, konsiderojmë se lidhja shkakore duhet të merret si kategori juridike

Në bazë të asaj që u tha deri më tani ngase nuk është provuar faj për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet i mbrojturi im, sepse akuza pa prova të sigurta dhe në bazë të supozimit të ekspertëve për mundësinë e evitimit të fatkeqësisë duke marrë si kusht nga

eksperti i komunikacionit [REDACTED] se nuk kishte automjete nga ana e kundërt, si kusht *sine qua non* e grupi i ekspertëve nuk bën fjale për këtë rrethane por që supozohet, duke pasur parasysh edhe parimin *in dubio pro reo*, propozoj që gjykata të merre aktgjykim me të cilin e liron të akuzuarin nga akuza e këtij propozim e bëjmë, sepse me provat që janë nxjerrë në këtë procedurë penale nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij i cili nuk e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë mbrojtjes që e ka dhënë i mbrojtësi i tij në të gjitha fazat e procedurës, si dhe në fjalën përfundimtare dhënë me shkri avokati i tij se për veprën penale për të cilën akuzohet nuk është fajtor dhe ka kërkuar nga gjykata që ta liron nga përgjegjësia penale dhe të bëjë aktgjykim lirues.

Gjykata gjatë prezantimit të provave ka dëgjuar përfaqësuesin ligjor të ndjerit prindin e tij [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.07.2017, dëshmitarin [REDACTED] si dhe është dëgjuar eksperti i komunikacionit [REDACTED] dhe, Leximi i super ekspertizës mbi aksidentin e komunikacionit e përpiluar nga grupi i ekspertëve prof. Dr. [REDACTED] Msc. [REDACTED] dhe Msc [REDACTED] nga Universitetit të Prishtinës " Hasan Prishtina " Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike , dëgjimi i ekspertit [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.04.2018, dëgjimi i ekspertit prof. [REDACTED], si anëtarë i grupit të hartimit të Super ekspertizës mbi aksidentin e komunikacionit në shqyrtimin gjyqësor me datën 19.06.2018, skica dhe fotografitë e vendit të ngjarjes fletë lëshimi me epikrizës i datës 25.09.2005, shqimi i foto dokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndës, dhe është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarës, të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Gjykata duke i vlerësuar provat e zbatuara në shqyrtimin gjyqësor veç e veç dhe në tersi konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Dëshmitari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor, ka deklarua edhe pse ka kaluar një

kohë e gjatë por atë ditë ka dërguar një bager ne Prishtine tek një Firmë e ndërtimtarisë qe kam pas me fillua pune, e kam len ne vendin e destinuam dhe kam planifikuar te kthehem me autobus. Duke u kthyer për ne Ferizaj dikur rreth orës 19:00 ne mbrëmje kur kemi arritur ne fshatin Prelez i Muhaxherve me kujtohet tani i ndjeri , personi i cili ka hipur në autobusë i cili tani ka ndërruar jetë unë nuk e kam njoftuar por ai me kishte njoftuar mua dhe me ka përshëndetur dhe është ulur ne karrige me mua deri ne Ferizaj, autobusi ka hyre atë dite ka tregu i bagëtive me qe rruga e Gjilanit ishte duke u punuar dhe kishte pengesa, dhe ne kemi zbritur dhe se bashku kemi ecur ne këmbë ne ane e djathtë te rrugës, ne drejtim Prishtinës Shkupë, më kujtohet dhe unë i thash ati se unë udhëtoj vetëm sonet, ndoshta ti udhëton çdo dit ne mbrëmje a ki ndonjë drite me vete, i ndjeri me tha sonet nuk e kame me vete pasi qe ja kishte len nenës se ti e cila kishte për te gatuar një fli dhe ju kishte nevojitur, ne kemi lëvizur varësisht prej situatës se rrugës diku ka pasur hapësirë a te ngushta e disa vende hapësira te gjere, qe d.m.th diku duku kemi ecur paralel e here njeri pas tjetrit, mire po sa me kujtohet për ditën qe kishte ndodhur aksidenti kishte ra shi dhe ishin krijuar disa pusetë te ujit dhe me te arritur tek vendin i ngjarjes aty ka qen afër një plaç ndërtimore dhe një pusi i ujit i krijuar me i madhe, ai ka qen pas meje dhe unë para tije e kam kaluar ketë puse nga ana e djathte , mirëpo unë nuk e kame para por mendoj se kamën e ka qitur nga ana e majte për ta kaluar ketë puset, dhe unë e kam para te ndjerin qe është rrezuar ne tok por kem mëndur qe i ka ra braniku i veturës së vozitësit , dhe unë duke mëndur qe të ndjerin e kam mbrapa dhe duke i than se a e pa se si i ra braniku i veturës, por ne fakti ishte kane ai-tani i ndjeri, e kam par qe ka ra jashtë rrugës e jo ne asfalt, në mesë të puseve dhe të ndjerit distanca ka qen për afërsisht diku rreth 10 metra, dhe person qe është prezent ne sall ku te njëjtin se kam par asnjëherë pos ditës kritike, i njëjti e ka ndal veturën dhe mu ka drejtuar mua personalisht dhe duke mu thënë “ se çka ke qatë qe e godita” dhe unë u përgjigja duke i thënë se ke goditur një peronë, pas këtij momenti aty afër pos kane dëgjuar se ka ndodhur diçka ka ndalur disa person nga një lokal mekanik dhe ata pos a janë njoftuar me rastin i kane ndihmuar personit qe akuzohet, ndërsa unë kame vazhduar tek” Hib-Petroll ” me njoftua qe punëtorit te tyre i ka ndodhur një raste, dhe pronari i Hib-Petroll e njoftoj se personi për te cilin tani ka aksidentuar kemi qen duke e pritur për ndërrim te natës, me qe i ndjeri ishte i punuar, i ndjeri kishte te veshur jelekun e punese me shkrimë të “ Hib-Petroll” se uniformen qe e ka pasur i ndjeri edhe sot kjo firme nuk e ka ndërruar, veshja e tij ka qen e gjelbër edhe pantallonat edhe të epërmen, mirëpo

ngjyra dallues ka qen ngjyra e verdhe, nuk e di se a ka pasur shenja jete. Në natën kritik siç me kujtohet ka qen nate me e erret se ditëve te tjera dhe e vranët , me qe ishte me vranët koha me e vështir ka qen pamja për te vozitur, prej vendin kur kemi zbritur distanca ka qen rreth 200-300 metra , ka pas lëvizje te automjeteve pasi qe ka qen rruge e kalueshëm, unë nuk mundemi te them se e ka kaluar rrugën pasi qe nuk e kam pare, ne momentin e përplasje nuk me kujtohet se ka pasur automjet tjetër.

Në shqyrtimin gjyqësor eksperti i komunikacionit [REDACTED] ka deklaruar se mbetet në tërësi në ekspertizën që e ka dhënë për këtë rast me datën 22.01.2007 ku shkaktar i këtij aksidenti është dalja e pakujdesshme dhe e befasishme e këmbësorit nga bakina në rrugën automobilistike, duke i ikur sipërfaqes së papërshtatshme për lëvizje jashtë rrugës, këtij aksidenti i ka kontribuar ngasja e veturës "Ford Eskort" nga ana e vozitësit të tij pa vëmendje të përqendruar përpara duke mos vërejtur këmbësorët përkaj rrugës në anën e djathtë dhe nga pakujdesia dhe mos përqendrimi i duhur as nuk e ka vërejtur këmbësorin duke kaluar nga bankina të rrugën automobilistike ku në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit në vazhdim ka deklaruar se sipas kushteve të cilat kanë qenë shpejtësia të cilën e ka zhvilluar shoferi i veturës " Ford Eskort " me atë shpejtësi të lëvizjes nuk ka pasur mundësi të evitimit të aksidentit e cila shpejtësi sipas metodës së goditjes së kokës së këmbësorit në gjam, në mungesë të gjurmëve të frenimit është përcaktuar shpejtësia e cila ka qenë 50-60 km/h e gjithë analiza është bërë duke u bazuar në gjendjen faktike se ai ka lëvizur në këtë shpejtësi. Por në rrugën ku është shkaktuar aksidenti nga procesverbali i raportit hetues të kohës kur a ndodhë aksidenti nuk ka pasur kufijtë të shpejtësisë në vendbanim apo jashtë vendbanimit por vozitësi i veturës është dashur të ketë vëmendje më të përqendruar për shkak kushteve jo të mira atmosferike ka qenë errësirë, dukshmëria e zvogëluar moti me riga shiu shtresa e rrugës e lagur pra kanë qenë kushtet e papërshtatshme normale për zhvillimin e shpejtësisë maksimale për lëvizje. Në bazë të vlerësimit të gjitha provave që ka analizuar ka arritur në përfundim se është e vërtetë se vozitësi nuk e ka vërejtur fare këmbësorin ku pas goditjes sipas deklaramit të tij nuk e ka ditur se çka ka goditur edhe pse në ekspertizë ka konstatuar se me drita të ulura (të shkurta) mund të vërente në distancë 26 metra në rrugë të errëta por vozitësi në këtë rast me shpejtësinë që e ka pasur veturën ka qen e pa mundur që ta evitoj aksidentin pasi dalja e këmbësorit ka qenë e pa pritur në vendin e errësirës në rrugë deri në 1 metër.

I akuzuari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor në mbrojtje e dhënë ka deklaruar se mbetet në pranë deklaratës që ka dhënë gjatë procedurës hetimore në prokurori dhe në vazhdim

deklaroi se veturën atë natë e ka vozitur me një shpejtësi normale dhe në vendin ku ka ndodhë aksidenti ka qenë terr dhe ishte duke ra shi dhe pas aksidentit e ka ndal veturën dhe ka parë një person i cili ishte duke ardhur në drejtin të tij dhe e ka pyetur atë person çka u bë ku i ka thënë se e ke goditur një person ku e ka parë pastaj personin që tani ka ndërruar jetë dhe së bashku me një person tjetër e kanë bartur në një veturë tjetër dhe e kanë dërguar në emergjencë, kurse ky ka pritur policin në vend të ngjarjes por pas aksidentit është ndje në gjendje shumë të rëndë shëndetësore dhe për momentin i kishte humbur vetëdija dhe është dërguar në emergjencë për dhënien e ndihmës së parë për qetësim. Në vazhdim ka theksuar se sa kujtohet i nderi ka vdekur pas dhjetë ditëve të qëndrimit në spital ku babai i tij dhe vëllai kanë shkuar disa herë për ta vizituar në spital tani të ndjerin, familjarët e tij kanë marrë pjesë në varrim e më vonë janë pajtuar me familjen e të ndjerit.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 20.04.2018 me propozimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit ishte ftuar një anëtar i grupit të hartimit të super ekspertizës ku në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë anëtar i grupit eksperti i komunikacionit Mr.sc [REDAKTUAR] asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në UP i cili ka dhënë sqarimet kërkuar si ekspert lidhur me super ekspertizën që e kanë harruar si grup dhe në tërësi ka mbetur në përfundimin që e kanë dhënë si grup i ekspertëve duke u mbështetur në tërësi në atë që e kanë hartuar me shkrim dhe që gjendet në shkresat e kësaj lënde penale.

Gjykata nga mendimi dhe konstatimi i Ekspertit të komunikacionit prof. Dr. [REDAKTUAR] i dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar gjendjen faktike, i cili veç të tjerash deklaroi: lidhur me lëshimin e ngasësit të automjetit "Ford Eskort" që është cek se kanë qenë me lëshime shumë të vogla në bazë të përvojës në përfundime nxjerrim lëshimet primare dhe sekondare kuptohet lëshimet primare janë esenciale që kanë ndikuar në shkaktimin e aksidentit me shume se 50%. Në rastin konkret lëshimet ngasësit të automjetit nga grupi i eksperteve janë vlerësuar me pak se sekondaret çka do të thotë se nuk e kanë plotësuar kushtin për tu vlerësuar si lëshime sekondare këtë e nënkuptojmë me lëshime "shume të vogla".

Për ta sqaruar lëshimin konkret në këtë rast drejtuesi i automjetit "Ford Eskort" është dashur të përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë dhe ka pasur mundësinë që pa kaluar në shiritin e kundërt të evitohet aksidenti me një kujdes me të shtuar me një shpejtësi me të vogël se sa ajo që është e lejuar sepse shpejtësia edhe 54 km / h në orë në një zonë ku kufizimi është 60

km / h në orë. Ku jemi te rasti konkret në faqe 11 të super ekspertizës është treguar hapësira në dispozicion që ka pasur ngasësi i automjetit " Ford Eskort " dhe atë 2.75 m, ku është gjerësia e shiritit qarkullues 3,75 m, pra duke ia hequr një metër të cilën e ka zënë këmbësori, automjeti " Ford Eskort " ka pasur hapësirë teknikisht të mjaftueshme që të anashkaloj këmbësorin. Si grup i eksperteve është jo profesionale të lëshohemi në aftësitë e rasteve të veçanta p.sh. duke shikuar moshën e shoferit apo edhe të dhënat tjera personale të shoferit në duhet ti japim vetëm ato rezultate që janë të bazuara në prova e jo në hamendësime është obligim se pari profesional për shkak se në nuk mund të arsyetohemi për mos dije, kështu që kjo na obligon që konkluzionet tona përkatësisht përfundimet të jene sa me profesionale dhe në fund ka deklaruar se si komision nuk e kemi praktik që saktësisht ti precizojmë me përqindje lëshimet përveç asaj që primaret janë me shume se sekondaret dhe në rastin konkret lëshimet shume të vogla janë me pak se sa lëshimet sekondare. Nga të gjitha shkresat e kësaj lende penale provat që na janë ofruar askund nuk na ofrohet se a ka pasur apo nuk ka pasur automjet duke lëvizur në anën e kundërt por në rastin konkret drejtuesi i automjetit ka pasur hapësirë në dispozicion teknike që ta evitoj apo shmang aksidentin.

Nga super ekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit e përpiluar nga grupi i ekspertëve Prof [REDAKTUAR] Msc [REDAKTUAR] dhe Msc [REDAKTUAR] nga Universitetit të Prishtinës " Hasan Prishtina " Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, gjykata ka vërtetuar se aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve kryesore të këmbësorit, por në masë të vogël i ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit automjeti " Ford Eskort " ku lëshimet e këmbësorit kanë qenë: nuk i ka kushtuar rëndësin e duhur lëvizjes së automjeteve në rrugën automobilistike në mënyrë që tu lëshoj rrugën në rastin kur afrohen. Ka ndërmarrë veprimin e anashkalimit të pusetës duke shfrytëzuar për lëvizje rrugën, pa u siguruar paraprakisht se me këtë veprim do të rrezikoj veten dhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacion. Lëshimet e ngasësit të automjetit automjeti " Ford Eskort ", kanë qenë "shumë të vogla" edhe atë nuk ka treguar kujdesin e duhur gjatë lëvizjes në kushtet e dukshmërisë së kufizuar, në mënyrë që të ndërmarr veprimet e nevojshme për evitim e aksidentit (në rastin konkret ka pasur mundësi teknike të ndërmarr veprimin e devijimit të trajektorës së lëvizjes majtas).

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plotë provave të nxjerra e të cilat deklarata kanë lidhshmëri njëra me

tjetrën, me ç' rast ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore neni nenin 42.2 të LSKRR-së duke menduar me mendjelehtësi se nuk do të shkaktohet pasoja e ndaluar, në atë mënyrë që duke e vozitur veturën e tipit " Ford Eskort " me targa [REDAKTUAR] në shpejtësi prej 50-60 km/h, pa vëmendje të përqendruar përpara duke mos e vërejtur këmbësorin kur ka kaluar nga bankina në rrugën automobilistike, dhe me pjesën e përparme të djathtë të veturës e ka goditur dhe hedhur në trotuar këmbësorin [REDAKTUAR], i cili në mënyrë të befasishme dhe të pakujdesshme kishte dalë në rrugën automobilistike duke i ikur gropës me ujë, dhe si pasojë e kësaj goditje këmbësori ka marrë lëndime të rënda trupore, nga të cilat pas 5 ditëve ndërrohet jetë në spital.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, se ka shkelë ligjin mbi trafikun publik dhe ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, duke menduar me mendjelehtësi se nuk do të shkaktohet pasoja e ndaluar, në atë mënyrë që duke e vozitur veturën 50- 60 km/h, pa vëmendje të përqendruar përpara duke mos e vërejtur këmbësorin ka kaluar nga bankina në rrugën automobilistike, me çka ka shkel nenin 42.2 të LPSKRR, me shkeljen e nenit të lartcekur përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën nga pakujdesia, duke mos i kushtuar vëmendje të mjaftueshme pa i verifikuar paraprakisht se a i pengon-rrezikon pjesëmarrësit e tjerë për çka edhe është shkakuar aksidenti dhe ka rezultuar me një të vdekur pra edhe nga super ekspertiza e hartuar nga grupi i ekspertëve kanë cekur se lëshimet e ngasësit të automjetit " Ford Eskort " kanë qenë shumë të vogla, pra nuk ka treguar kujdesin e duhur gjatë lëvizjes në kushtet e dukshmërisë së kufizuar në mënyrë që të ndërmer veprimet e nevojshme për evitim të aksidentit pra gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarës duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit në mënyrë të hollësishme analizoi mbrojtjen e mbrojtësi të akuzuarit avokatit [REDAKTUAR] t cilën e ka dhënë me shkrim dhe e ka elaboruar hollësisht por në këtë rast gjykata nuk e akceptoi kërkesën e mbrojtjes për lirimin e të akuzuarit nga dënimi dhe përgjegjësia penale, sepse është vërtetuar përtej çdo dyshimi gjendja faktike nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 63 të KPK-së, kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar se nga kryerja e veprës penale kanë kaluar mbi 13 vite, i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimeve gjyqësore, gjithë herë me kohë është paraqitur në gjykatë dhe është ndjerë shumë rëndë ku nuk i hiqet nga mendja aksidenti që i ka ndodhë, me familjen tani të ndjerit janë pajtuar për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Rrethanë rënduese gjykata gjeti peshën e rëndë të veprës penale të shkaktuar nga veprimet e të akuzuarit, andaj duke vlerësuar këto rrethana, gjykata, të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi me dënim me kusht, në lartësinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i kushtëzuar i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme që të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, e që janë të parapara me nenin 34 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së dhe nenit 39

parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.52/2007 me datë 22.06.2018

Procesmbajtëse
Marigona Shaqiri

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.